



FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

Federata e Basketbollit
të Kosovës

+383 49 738 080
federata@basketbolli.com

Lagjia "Arbëria"
Blloku C3, Nr.83
Str: Radovan Zogovic
10 000 Prishtina

DORACAK PËR SHFRYTËZIMIN E HAPËSIRAVE REKLAMUESE NË LED

Edicioni 2025/26





1. Qëllimi dhe parimet kryesore

FBK synon të sigurojë një sistem modern dhe të unifikuar reklamimi LED në të gjitha palestrat e ProCredit Superligës dhe Superliga Femrat (një ndeshje derbi).

Ky sistem kontribuon në:

- Rritjen e vlerës së garës;
- Mbështetjen financiare të klubeve;
- Rritjen e ekspozimit të sponsorëve;
- Zbatimin e standardeve të FIBA-s për garat elitare.

2. Përputhja me standardet ndërkombëtare

Ky Doracak është hartuar duke u bazuar në praktikat e ligave elitare evropiane dhe në rekomandimet e FIBA-s për reklamimin digjital në LED. Ai siguron që basketbolli kosovar të ndjekë standardet më të mira të marketingut sportiv.

3. Përgjegjësitë e klubeve

- ⇒ Sigurimi i hapësirës për vendosjen e pajisjeve LED;
- ⇒ Asistimi me staf gjatë vendosjes së sistemit;
- ⇒ Qasje e papenguar dhe hyrje/dalje e sigurt për ekipin realizues;
- ⇒ Përgjegjësi për dëmet e shkaktuara nga tifozët apo anëtarët e klubit;
- ⇒ Raportimi i menjëhershëm i çdo dëmtimi tek FBK;
- ⇒ Bashkëpunimi me FBK për menaxhimin e sponsorëve.

4. Afatet dhe formatet e reklamave

- Reklamat dorëzohen minimumi 2 ditë para ndeshjes.
- Materialet dërgohen në email-in zyrtar.
- Formatet e pranueshme:
 - Video: MP4
 - Fotografi: JPEG
 - Dimensione: 1535x256 pixels
 - Kohëzgjatja: 6-15 sekonda
- Reklamat me cilësi të dobët nuk pranohen.



5. Procedurat standarde

Raportimi i dëmeve:

1. Zyrtarët e FBK dhe ekipi teknik bëjnë verifikimin pas çdo ndeshjeje.
2. Çdo dëmtim i pajisjeve LED do të riparohet sipas vlerësimit të bërë nga kontraktori teknik.
3. Kostot e riparimit përcaktohen për rastin konkret dhe i komunikohet klubit. Kjo metodë siguron që shpenzimet të jenë të sakta dhe të drejta sipas natyrës së dëmtimit.
4. Raporti i dëmit dërgohet brenda 24 orëve tek klubi.
5. Klubi ka 10 ditë kohë për mbulim të shpenzimeve.

Dorëzimi i materialeve:

1. Klubi plotëson formularin standard (**Aneksi 1**).
2. Dërgon materialet bashkë me listën e sponsorëve.
3. FBK jep aprovimin përfundimtar.

6. Përgjegjësitë dhe pasojat financiare

- Klubi mbulon 100% të kostos së dëmtimeve të pajisjeve LED të shkaktuara nga tifozët ose anëtarët e tij.
- FBK dërgon raportin e dëmit dhe pagesa kryhet brenda 10 ditëve.
- Në rast vonese, FBK ka të drejtë të:
 - Pezullojë hapësirat reklamuese të klubit;
 - Vendosë sanksione shtesë konform akteve normative në fuqi.

7. Ndarja e hapësirave reklamuese

- ✓ Klubi nikoqir: deri në 16 logo sponsorësh (përfshirë komunën).
- ✓ FBK: 10 hapësira pas çdo rotacioni të klubit.

Reklamat ndahen në mënyrë të balancuar për të siguruar dukshmëri të barabartë.

8. Këshilla për optimizimin e reklamave

- Ngjyra të ndritshme dhe kontrast të lartë.
- Mesazhe të shkurtra dhe të lexueshme.
- Logo në vend të dukshëm.
- Shmangni tekste të gjata dhe animacione të ngadalta.



9. Kontrolli i cilësisë

- FBK ka të drejtë të verifikojë të gjitha materialet paraprakisht.
- Reklamat duhet të jenë në përputhje me standardet teknike (format, dimensione, rezolucion, kohëzgjatje).
- Reklamat nuk duhet të përmbajnë mesazhe politike, fetare, diskriminuese ose që bien ndesh me vlerat e sportit.
- Nuk lejohen reklama që cenojnë të drejtat e sponsorëve zyrtarë të FBK-së ose partnerëve ndërkombëtarë (p.sh. FIBA, FIBA Europe).
- FBK rezervon të drejtën të refuzojë çdo material që nuk është në përputhje me politikat e marketingut dhe legjislacionin në fuqi.
- Klubet janë të obliguara të korrigjojnë dhe ridërgojnë materialet e refuzuara brenda afateve të përcaktuara.

10. Mbështetje për sponsorët

FBK dhe klubet ofrojnë këto përfitime për sponsorët:

- ✓ Ekspozim në sistemin LED gjatë gjithë ndeshjes.
- ✓ Promovim të integruar me komunikimet e FBK dhe klubeve.
- ✓ Mundësi për fushata të personalizuar në varësi të partneriteteve.

11. Shembull i një rotacioni në LED

Rotacioni i plotë me 30 pozicione:		
1. Intro Klubi Nikoqir	2. Sponsor	3. Intro FBK
4. Sponsor	5. Sponsor	6. Sponsor FBK
7. Sponsor	8. Sponsor	9. Sponsor FBK
10. Sponsor	11. Sponsor	12. Sponsor FBK
13. Sponsor	14. Sponsor	15. Sponsor FBK
16. Sponsor	17. Sponsor	18. Sponsor FBK
19. Sponsor	20. Sponsor	21. Sponsor FBK
22. Sponsor	23. Sponsor	24. Sponsor FBK
25. Sponsor	26. Outro Klubi Nikoqir	27. Sponsor FBK
28. Outro FBK	29. Sponsor FBK	30. Sponsor FBK



12. Pyetje të Shpeshta (FAQ)

- ⇒ **Çfarë ndodh nëse reklama nuk dorëzohet në kohë?**
Nuk pranohet dhe hapësira mund të mbetet bosh.
- ⇒ **Çfarë ndodh nëse reklama nuk është në formatin e duhur?**
Kthehet për korrigjim dhe mund të mos përfshihet në ndeshjen e radhës.
- ⇒ **Kush mbulon kostot në rast vonesash teknike?**
Nëse vonesa është nga klubi, ai mbulon kostot; nëse është teknike nga FBK, kostot mbulohen nga FBK.

13. Kontakti

Dren Hasangjekaj - Zyrtar për Marketing

✉ Email: marketing@basketbolli.com

☎ Tel: +383 44 224 488

Me respekt,

Elvira **DUSHKU**

Sekretare e Përgjithshme

Federata e Basketbollit të Kosovës



Prishtinë, 22.09.2025



ANEKSI I - FORMULARI STANDARD PËR DORËZIM REKLAMASH

1. TË DHËNAT E KLUBIT

- **Emri i klubit:** Click or tap here to enter text.
- **Palestra:** Click or tap here to enter text.
(Palestra, qyteti)

2. LISTA E SPONSORËVE DHE MATERIALEVE REKLAMUESE

Klubet duhet të dorëzojnë materialet sipas standardeve (MP4/JPEG, 1535x256px, 6-15 sekonda). Të gjitha materialet duhet të jenë të emërtuara me emrin e sponsorit dhe formatin përkatës (p.sh. *SponsorX_LED2025.mp4*).

Lista e sponsorëve deri më tash

(të gjitha materialet reklamuese për LED dërgohen 2 ditë para ndeshjes përkatëse):

Nr.	Emri i Sponsorit	Lloji i materialit (Video/Foto)	Koha e shfaqjes (sekonda)	Materiali (✓ dorëzuar)	Komente
1	_____	Choose an item. _____	_____	☐	_____
2	_____	Choose an item. _____	_____	☐	_____
3	_____	Choose an item. _____	_____	☐	_____
4	_____	Choose an item. _____	_____	☐	_____
5	_____	Choose an item. _____	_____	☐	_____
6	_____	Choose an item. _____	_____	☐	_____
7	_____	Choose an item. _____	_____	☐	_____
8	_____	Choose an item. _____	_____	☐	_____
9	_____	Choose an item. _____	_____	☐	_____
10	_____	Choose an item. _____	_____	☐	_____
11	_____	Choose an item. _____	_____	☐	_____



3. INFORMACION PËR MATERIALET

- **Numri total i sponsorëve të përfshirë:** Click or tap here to enter text.
- **Materialet do verifikohen nga personi përgjegjës i klubit:**
 - ☐ PO
 - ☐ JO

4. PERSONI I KONTAKTIT NGA KLUBI

- **Emri dhe mbiemri:** Click or tap here to enter text.
- **Pozita:** Click or tap here to enter text.
- **Numri i telefonit:** Click or tap here to enter text.
- **Email:** Click or tap here to enter text.

5. DEKLARATA

Me nënshkrimin e këtij formulari, klubi deklaron se materialet e dorëzuara do jenë në përputhje me specifikat teknike të kërkuara nga FBK dhe se mban përgjegjësi për çdo përmbajtje të tyre.

Ky formular duhet plotësuar nga klubet para fillimit të edicionit 2025/26, ndërsa për çdo ndeshje do të dërgojnë materialet reklamuese sipas Doracakut.

Data: Click or tap to enter a date.

Nënshkrimi i personit përgjegjës të klubit:
